



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 30

Prishtinë, më 9.12.2008, ora 12,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
nga mbledhja e Komisionit

Në mbledhje **morën pjesë**: Lulzim Zeneli, Myrvete Pantina, Berat Luzha, Selvie Halimi, Heset Cakolli, Elhëme Hetemi. Munguan : Dragisha Miriç, Ibrahim Selmanaj, Zulfi Merxha, Ali Lajçi dhe Zef Morina .

Të ftuarit dhe pjesëmarrësit tjerë : Blerim Vela-OSCE dhe zyrtarët nga MMPH: Laura Gjakova, Shukri Shabani, Nazmi Shkodra, për pikën e dytë ministri Idriz Vehapi dhe Muzafer Luma.

Nga stafi mbështetës i komisionit : Bajram Badivuku, Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi : **Lulzim Zeneli**, kryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,**
- 2. Anekset për projektin e Vlerësimit të ndikimit në Mjedis dhe amendamenti 6 për projektin e Mbrojtjes së Mjedisit,**
- 3. Informata nga Ministri i Bujqësisë rreth Pyjeve**
- 4. Të ndryshme.**

Kryesuesi, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes dhe hapi mbledhjen për pikat e rendit të ditës.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Kryesuesi konstatoi miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar pa vërejtje.

2. Anekset e projektligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Amendamenti 6 për projektligjin e Mbrojtjes së Mjedisit

Lidhur me këto çështje në këtë pikë kryesuesi **Lulzim Zeneli** pas konsultimit me zyrtarët e MMPH në pajtim me anëtarët e komisionit nxori :

K O N K L U D I M

I. Amendamenti 6 për projektligjin e Mbrojtjes së Mjedisit MIRATOHET me ndryshimet e bëra nga grupi punues udhëhequr nga deputetja Selvie Halimi:

Qeveria

1. Qeveria, në bazë të propozimit nga ministri pas konsultimeve me ministrat tjerë të interesuar, do të miratojë aktet nënligjore për qëllim të:

- të arrihen objektivat dhe implementimi i plotë të këtij ligji;
- të aplikohen parimet sipas nenin 6;
- të bëhet përshtatja e kërkesave ligjore dhe procedurave që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm me acquis-in mjedisor të Bashkimit Evropian.
- të bëhen kufizimet, ndalimet dhe kontrollet tjera të emisioneve të drejtpërdrejta ose jo të drejtpërdrejta të liruara në mjedis nga ndotësit dhe mbeturinat nga instalime dhe projekte;
- të përcaktohen metodat, pajisjet, ndërtimet dhe strukturat që duhet të zvogëlojnë emisionet nga bazat e asfaltit, impiantet e gurëthyesve, nxjerrjeve të gurëve apo aktiviteteve tjera të nxjerrjes së gurëve, pikat e karburanteve dhe aktiviteteve tjera të ngjashme;
- të bëhen kufizimet dhe ndalimet për emitimet nga makineria dhe pajisjet, për shfrytëzimin apo vendosjen në treg dhe për kërkesat e etiketimit;
- të bëhet trajtimi dhe përmbajtja e grumbujve të dheut-tokës së kontaminuar sipas standardeve teknike të trajtimit si dhe metodave të trajtimit dhe mbikëqyrjes;
- të përcaktohen metodat, pajisjet, ndërtimet dhe strukturat që duhet të zvogëlojnë emitimet nga bujqësia, ekonomia bujqësore e kafshëve, fermat e gëzofit, pylltaria dhe hurdhat e peshqve;
- të bëhet përcaktimi i mënyrës së pagesave për lejet mjedisore,
- të bëhet zvogëlimi i substancave që dëmtojnë shtresën e ozonit;
- të bëhet zvogëlimi i substancave dhe aktiviteteve që ndikojnë në ndryshimin klimatik;
- të zbatohen kriteret dhe procedurat për shfrytëzim instrumenteve për mbrojtje të mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm, sipas nenit 7;

2. Ministri :

- do të promovojë zhvillimin e qëndrueshëm në Kosovë dhe rajon;
- do të miratojë akte nënligjore, udhëzime administrative, formularë, procedura të cilat janë në përgjegjësinë e tij sipas këtij ligji;
- angazhohet për zbatimin e masave dhe standardeve mjedisore për të stimuluar shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore;
- do të koordinojë përgatitjen dhe implementimin e politikave dhe instrumenteve mjedisore me ministratë tjera, komunat, entitetet private, organizatat shkencore dhe profesionale, organizatat jo qeveritare dhe me qytetarët;
- do t'i propozojë qeverisë për miratim çmimoren për nxjerrjen e lejeve mjedisore, në bazë të nenit 31;
- do të bëjë propozimin e anëtarëve të Bordit Këshillues për Mbrojtjen e Mjedisit në Qeveri, i cili do të aprovohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.
- do të përcaktojë kriteret dhe procedurën për dhënjen e mirnjohjeve,
- do të sigurojë shfrytëzim të drejtë të fondeve të dhëna nga organizatat ndërkombëtare dhe vendore sipas politikave të qeverisë me qëllim të mbrojtjes së mjedisit. Gjithashtu bënë përgatitjen e aplikimit të bashkë-financimeve të BE-së për projektet e investimeve në mjedis dhe implementimin e tyre;

3. Komunat

a) Komunat do të:

- bëjnë aplikim të plotë të parimeve të nenit 6;
- bashkëpunojnë me Ministrinë për përgatitjen e planit, për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm brenda territorit të tyre sipas këtij ligji,
- zbatojnë ligjet dhe bëjnë inspektimin e zbatimit të ligjeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm brenda territoreve të tyre,
- përgatisin dhe sigurojnë informata për qytetarët në lidhje me mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin të qëndrueshëm;

b) Planin për mbrojtje të mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm brenda territorit të komunës, e aprovon Kuvendi komunal përkatës.

II. Anekset e projektligjit për Vlerësimin e ndikimit në Mjedisit miratohen me ndryshimet që janë sugjeruar nga mbledhja e kaluar e komisionit:

Në shtojcën 1 përmirësohet si vijon :

Industria ekstraktuese

15. Gurore dhe miniera të hapura, në sipërfaqe më të madhe se 5 ha, ose nxjerrje të torfës, në sipërfaqe më të madhe se 10 ha ose nxjerrja e më tepër se 15.000 ton/vit.

Industria kimike

c) Për prodhimin e plehrave kimike me bazë fosfatike, azotike ose të kaliumit (plehra kimike të thjeshta ose të përbëra,

Industria energjetike

19. Centrale të energjisë nukleare,

Në shtojcën 2 përmirësohen si vijon :

2. Industria ekstraktuese

Gurore, miniera të hapura dhe nxjerrje torfe përfshirë këtu vendet e identifikuar për punime të zejeve (projekte që nuk përfshihen në Shtojcën 1)

7. Industria ushqimore

g. Instalime industriale për prodhimin e niseshtesë,

13. Çdo ndryshim ose zgjerim i projekteve të dhëna në Shtojcën I ose Shtojcën II, të cilat janë të lejuara, të realizuara ose në proces të realizimit, të cilat ndryshime ose zgjerime mund të kenë ndikime të theksuar jo të favorshme në mjedis;

- Projektet në Shtojcën I, të ndërmarra ekskluzivisht ose kryesisht për zhvillim ose testim të metodave ose produkteve të reja dhe që nuk janë përdorur për më tepër se dy vit

3. Lidhur me pikën 2 **Lulzim Zeneli** përshëndeti ministrin **Idriz Vehapi** dhe kryeshefin e APK **Muzafer Luma** të cilët edhe një herë njoftoi me shqetësimet e komisionit rreth pyjeve sidomos pas rekomandimeve të miratuara nga Kuvendi dhe rreth kërkesës për informim në mbledhjen e sotme.

Ministri falënderoi për ftesë ngase si tha ai kjo temë meriton të debatohet sidomos pas keqësimit gradual të gjendjes pyjore në Kosovë në 10 vjetët e fundit. Në këto 11 muaj të këtij mandati kontributi i ministrisë së bujqësisë në drejtimin e aplikimit të rekomandimeve të Kuvendit nga 16 tetori 2008 janë si vijon :

1. Anulimi i Tendereve, nuk ka të bëjë me ministrinë ngase tendere nuk ka pasur. Ministrisë i është lejuar kërkesa rreth pastrimit të pyjeve dhe prerjeve fito-sanitare (për shkak të sëmundjeve të ndryshme) në komunën e Deçanit.

2. Rreth planeve menaxhuese mund të thuhet se këto plane janë në përgatitje e sipër dhe kërkojnë kohë, ngase janë 82 njësi që duhet përgatitur plane.

3. Ndryshimi i Ligjit për Pyje gjithashtu është në procedurë dhe në fund të muajit do ti dërgohet Qeverisë në miratim. Është dashur të harmonizohet me pakon e Ahtisarit.

4. Ristrukturimi i rojeve të pyjeve është bërë dhe vazhdimisht bëhet duke ashpërsuar masat disiplinore ndaj rojtarëve, mirëpo ka edhe pengesa nga keqbërësit (demolime të automjeteve etj). Është përforcuar bindja në ministri se vetëdijesimi duhet të jetë i dhunshëm , ngase rrugët tjetër nuk ka.

5. Lehtësirat doganore duhet patjetër të kërkohen ngase është kërkesë e arsyeshme e Kuvendit sidomos për përpunuesit e drurit, por duhet bërë edhe analiza për të cilat ministria do të njoftoi këtë komision më vonë.

6. Qeveria e Republikës së Kosovës duhet patjetër të kërkojë seriozitet më të lartë nga Gjykatat, ngase ministria në punën e deritanishme ka pasur mjaft probleme rreth mosrealizimit të lëndëve ose me joefikasitetin e tyre.

Sa i përket mbështetjes së fermerëve , ai tha se ka pasur vullnet në këtë Qeveri, por FMN është ajo që pengon , ngase investimet duhet bërë vetëm në projekte kapitale. Dmth derisa të anëtarësohemi duhet të vazhdohet në këtë mënyrë.

Muzafer Luma në vazhdim konkretizoi atë çka diskutoi ministri me kërkesën rreth mjeteve financiare-buxhetore, ngase planifikimi kërkon financim. Ai tha se Kosovës i është lejuar prerja e 500.000 kubikëve në vjet-prerje të rregullta. Ristrukturimi nuk mund të jetë efikas nëse një roje që është përgjegjës për 2000 ha, ka pagën prej 130 euro, përpos kësaj ai nuk ka vikende përveç që është në vendin e punës thua se pakufi. Në këtë gjendje kur secila ministri kërkon policinë e vet, vështirë është të arrihet efikasiteti që dëshirohet. Agjensioni sa i përket kërkesës që duhet bërë gjykatave, nuk ka mundësi të realizoi detyrat , ngase nuk ka kompetenca. Ekonomitë Pyjore janë në kompetencë të AKM dhe aty nuk ka mundësi të bëjë asgjë ministria.

Lulzim Zeneli megjithatë konstatoi se është gjendje e rëndë e krijuar, ngase rezultatet nga tereni e vërtetojnë këtë, të cilat janë evidentuar me rastin e vizitave që ka pasur ky komision, ndaj tendenca e komisionit është të ndryshohet gjendja e krijuar me intervenim emergjent. Rojet e pyjeve duhet të rikonceptohen nga vet ministria, ngase nuk funksionojnë, mirëpo rekomandimet janë drejtuar më tepër Qeverisë e cila duhet të mbështesë ministrinë e drejtësisë në aspektin e efikasitetit të gjykatave. Në fund ai konstatoi se të gjitha këto të dhëna tregojnë se gjendja shkon nga më e keqja, dhe e tëra kjo duhet të shërbejë në funksionimin e përbashkët të institucioneve.

Heset Cakolli njoftoi më hollësisht zyrtarët e ministrisë rreth vizitave të komisionit në Deçan dhe Rugovë dhe alarmoi të njëjtit lidhur me atë çka është evidentuar në vizitë. Ai tha se tepër masë e madhe e drunjve barten ilegalisht në këtë anë të Kosovës. Gjithashtu theksoi problemin me kufirin e Malit të Zi ku personat shkojnë të marinë leje për të prerë në Kosovë. Z. Luma intervenoi duke thënë se pyjet private janë gjë tjetër, derisa në ato publike janë të ndaluara prerjet.

Selvie Halimi përshëndeti iniciativat e ndërmarra nga ministria e bujqësisë sepse ato qojnë në realizimin e rekomandimeve, por theksoi problemet gjyqësore të cilat janë bërë “normale” për keqbërësit, ngase dikush pajtohet të vuajë 10 ditë burgim për një rehati dimërore, ndaj kërkojë nga ministria më tepër angazhim në këtë drejtim.

Myrvete Pantina gjithashtu u pajtua me disa konstatime nga zyrtarët prezent, por megjithatë duhet të dominojë një gjendje e rregullt (me prerje të rregullta) me planifikim të mirëfilltë, tha ajo dhe pyeti a kanë pasur mirëkuptim zyrtarët e ministrisë me Qeverinë rreth buxhetit për vitin 2009.

Elhëme Hetemi tha se duhet eliminuar dilemat e APK në mënyrë që të ngjallet optimizmi, gjithashtu bashkëpunimi me qytetarë të jetë në nivelin e lartë derisa të shohim se po fillon aritja e rezultateve.

Berat Luzha shtoi shqetësimet e tij sa i përket diskutimit të z. Cakolli rreth prerjeve në Rugovë, sugjeroi zyrtarët e ministrisë ta vizitojnë grykën e Rugovës. Ai këtë shqetësim e ilustroi me pamjet që shihen përditë nëpër rrugët tona, duke mos i penguar askush prerësit ilegal të cilët bartin poshtë e lartë drunj, sidomos drunj teknik. Me një fjalë ai tha se pyjet

tona po shkretohen anembanë Kosovës, ndërsa APK u shndërrua në një strukturë joprofesionale duke formuar disa zyra regjionale të cilat nuk janë ligjore.

Lulzim Zeneli falënderoi të gjithë pjesëmarrësit të cilët bashkërisht u munduan të alarminojnë gjendjen aktuale në pyjet e Kosovës dhe kërkoi nga zyrtarët e ministrisë të angazhohen edhe përmes medijave në këtë drejtim.

Mbledhja përfundoi në orën 15,00.

Kryetari i Komisionit,
Lulzim Zeneli